

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Ëngjëllushe Isa Guri”.

PJESËMARRJA :

KQZ

- 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë seancën me këto çështje në rendin e ditës, projektvendime që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në këshillat bashkiakë Skrapar, Maliq, Patos, Cërrik. Pika tjetër e rendit të ditës ka të bëjë me “Shqyrtimin administrativ të rezultateve të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Tom Doshi”. Pika e shtatë ka të bëjë me “Shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare në zhvillimin e veprimtarisë për qëllime zgjedhore në ambjentet e Bibliotekës “Moikom Zeqo” me pjesëmarrjen e kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste. Pika e tetë “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare për zhvillimin e veprimtarisë për qëllime zgjedhore në ambjentet e Bibliotekës “Misto Treska” me pjesëmarrjen e kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste”. Fillojmë me katër pikat e para të rendit të ditës që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në këshillat bashkiakë: Skrapar, Maliq, Patos, Cërrik. Po!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Skrapar ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, nga këshilltaria zonja Mimoza Demçe, propozuar nga Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Skrapar, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 18, zonja Engjëllushe Isa Guri. Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 2190, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, zonjës Engjëllushe Isa Guri, në Këshillin e Bashkisë Skrapar, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Zyra e gjendjes civile ende nuk ka kthyer përgjigje. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar në Këshillin e Bashkisë Skrapar, e cila rezulton pa shënime dhe e padënuar. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatoj se: të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Skrapar, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë: bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164 pikat 2 dhe 4, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, nenin 11, të ligjit nr.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Zonja Engjëllushe Isa Guri, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Skrapar, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Engjëllushe Isa Guri.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr.461

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



11.11.2021
Ora 12:09

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Irakli Hasan Gjoni”.

PJESËMARRJA :


KQZ

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, B. Kodra**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Skrapar ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, nga këshilltaria zonja Xhuli Hysi, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Skrapar, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 17, zoti Irakli Hasan Gjoni, i cili ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 2189. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin për dekriminalizimin. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar të Këshillit të Bashkisë Skrapar, i cili

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021**

rezulton se nuk ka shënime në sistem, pra është i padënuar. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Skrapar, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po edhe për këtë rast, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164 pikat 2 dhe 4, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Zoti Irakli Hasan Gjoni, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Skrapar, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Irakli Hasan Gjoni.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr.462

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



11.11.2021
Ora 12:11

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Maliq, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Xhensila Pëllumb Nakoleci”.

PJESËMARRJA :


KQZ

- 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: Y. Merkaj, M. Koja, B. Kodra

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Maliq ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, nga këshilltaria zonja Elvisa Demollari, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Maliq, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 31, zonja Xhensila Pëllumb Nakoleci, e cili ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje ku rezulton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021**

gjendjes gjyqësore ku rezulton se nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Maliq, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164 pikat 2 dhe 4, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Zonja Xhensila Pëllumb Nakoleci, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Maliq, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Maliq, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Xhensila Pëllumb Nakoleci.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr.463

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



11.11.2021
Ora 12:13

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Patos, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Dorian Sokrat Çapo”.

PJESËMARRJA :

KQZ

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, B. Kodra**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Patos ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, nga këshilltaria zonja Orges Gollosi, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Patos, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 22, zoti Dorian Sokrat Çapo, e cili ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2188. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit për këshilltar në Këshillin e

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021**

Bashkisë Patos, ku rezulton se nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Patos, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164 pikat 2 dhe 4, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Zoti Dorian Sokrat Çapo, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Patos, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Patos, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Dorian Sokrat Çapo.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr. 464

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



11.11.2021
Ora 12:15

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Cërrik, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Aurel Ramis Musta”.

PJESËMARRJA :

KQZ

- 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: Y. Merkaj, M. Koja, B. Kodra

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër e fundit në lidhje me plotësimin e vakancave, Këshilli i Bashkisë Cërrik!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Cërrik ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, nga këshilltaria zonja Edije Jançia, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumemërore e këtij subjekti, për Këshillin e Bashkisë Cërrik, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 21, zoti Aurel Ramis Musta, i cili ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2184. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pasi ka verifikuar kërkesën tonë konstaton se nuk ka ndryshime në përbërjen e gjendjes

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021**

civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit për këshilltar në Këshillin e Bashkisë Cërrik, ku rezulton se nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Cërrik, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord, atëhere bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164 pikat 2 dhe 4, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Zoti Aurel Ramis Musta, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Cërrik, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Cërrik, me kandidatit nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Aurel Ramis Musta.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr. 465

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



11.11.2021
Ora 12:17

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për deklarin të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar të procedurës administrative të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Tom Gjek Doshi, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Qarku Tiranë/Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PJESËMARRJA :

KQZ

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, B. Kodra**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Tom Gjek Doshi

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “kandidati për deputet i Kuvendit të Shqipërisë”. Në zbatim të këtyre dispozitave”, zoti Tom Gjek Doshi, kandidat për deputet i listës shumemërore të propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 1754. Komisioni Qendror


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021**

i Zgjedhjeve, fillimisht bën verifikimin paraprak, për të gjithë të dhënat e deklaruara nga këta subjekte, duke marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 157 datë 17.03.2021, vendosi “Miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate e Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”. Duke pasur parasysh shënimet e bëra në rubrikën III të Formularit të Vetëdeklarimit, “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”. Pyetjes 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se: Me vendimin nr. 18 datë 25.05.1990, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Rrethit Durrës, e ka dënuar për veprën penale “Sjellje e Padenjë në Shoqëri”, parashikuar nga neni 121 dhe 31/a i K.P, për të cilën është vendosur masa e dënimit 1 (një) vit heqje lirie. Pyetjes 4, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se: Është ndaluar/arrestuar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas urdhërit të ndalimit të Prokurorit të Përgjithshëm datë 26.03.2015, për periudhën 26.03.2015-28.03.2015, rezultat i së cilës është masa arrest në shtëpi. Pyetjes 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se: Është caktuar masë e sigurisë detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore dhe arrest në shtëpi, masa të cilat janë revokuar më vonë nga Gjykata e Lartë. Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se: Ka jetuar në Adelaide/Australi, për të bashkëjetuar me familjen në vitin 1997 e në vijim. Ka jetuar në Heilbronn/Gjermani, për arsye emigracioni në dhjetor 1992. Nisur nga deklarimet

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021**

e zotit Tom Doshi, në formularin e vetëdeklarimit si dhe nga indicje të ardhura për shkak të shpalljes “non grata” nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës të këtij subjekti vetëdeklarues, bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të Personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 17/2016 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendos t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra. Në datë 04.11.2021, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Tom Gjek Doshi”. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda dhe jashtë vendit, i konsideron këto verifikime të plota bazuar në përcaktimet e nenit 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Tom Gjek Doshi. Pas paraqitjes së rezultatit të verifikimit nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të përcaktimeve të nenit 10 të ligjit nr. 138/2015, është organi kompetent i cili nëpërmjet vendimarrjes konstaton nëse ekzistojnë kushtet e ndalimit për të kandiduar sipas përcaktimeve të këtij ligji. Zoti Tom Doshi, kandidat i subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 ka fituar tre mandate. Edhe pse i renditur i pari në listën shumë-mërore të këtij subjekti, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me shkrim, protokolluar në KQZ me shkresën nr. 4500 prot., datë 26.04.2021, nëpërmjet të cilës deklaron se me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë jep dorëheqjen nga lista shumë-mërore e kandidatëve për


**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021**

deputetë të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nëpërmjet kërkesës së tij me shkrim, zoti Tom Gjek Doshi, i kërkon KQZ-së të bëjë zëvendësimin e tij si deputet sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, në shkresën e tij ai shprehet se sa më sipër kërkuar, është në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe se nuk ka as në datën 26 Prill 2021 (data e nënshkrimit të shkresës) dhe as në të ardhmen asnjë pretendim me vendimin e KQZ-së sipas të cilit mandati i tij i kalon kandidatit tjetër sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Dorëheqja e nënshkruar nga zoti Tom Doshi është e parevokueshme. Me vendimin nr.409 dhe 410 datë 23.06.2021 Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore, përkatësisht Qarku Tiranë dhe Qarku Shkodër, janë përcaktuar kandidatët fitues të listës shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate, sipas të cilëve rezulton se zoti Tom Doshi, nuk ka përfituar mandatin e deputetit. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidati i listës shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, nuk do të mund të përfitojë mandat për këtë legjislaturë, Komisioneri nuk mund të shprehet për sa kohë ky subjekt, nuk gëzon statusin e deputetit dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit 138/2015, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i verifikimit të thelluar. Bazuar në pikat 2 e 3, të nenit 90, dhe në nenin 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, është në diskrecionin e organit kompetent të deklarojë të përfunduar procedurën

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

administrative pa një vendim përfundimtar. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po faleminderit, atëhere edhe njëherë përmbledhur! Jemi në situatë të ngjashme me rastet e tjera, kur personat për të cilët Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar procedurat e verifikimit, përfshirë dhe ato të thelluara, e kanë humbur cilësinë, sipas të cilës për shkak të ligjit do t'i nënshtroheshin këtij procesi. Ky është dhe rasti i zotit Tom Doshi. Zoti Tom Doshi, aktualisht nuk përfshihet në rrethin e subjekteve për të cilët do të duhej sipas ligjit 138/2015 t'i nënshtrohej procesit të verifikimit. Nuk ka as mandat deputeti dhe në asnjë lloj rrethane nuk mund ta fitojë këtë mandat. Ndaj rekomandohet që procedura administrative të përfundojë pa vendim. Kjo është ideja. Dakord!

Atëhere, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, vendos:

1. Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues zotin Tom Gjek Doshi.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr. 466

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



11.11.2021
Ora 12:26

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për rishqyrtimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në lidhje me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e bibliotekës “Moikom Zeqo”, me pjesëmarrjen e kandidatit për deputet, zoti Alqi Bllako”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja,**
- **Të tjerë:**
 1. Organizata “Qëndresa Qytetare” **R. Xhemollari**
 2. Njësia Administrative nr.2, Tiranë **F. Pullazi (administrator)**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qëndresa Qytetare”, për aktivitetin elektorale të zhvilluar në ambientet e Bibliotekës “Moikom Zeqo”, me pjesëmarrjen e kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste. Kemi prezent përfaqësues të organizatës Qëndresa Qytetare. Nga ana e njësisë administrative? Ju jeni kryetari i njësisë?

Z. F. Pullazi: Jo, unë jam administratori i Njësisë nr.2!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

Z. I. Celibashi: Adminsitratori i Njesisë nr.2, ku ndodhet Biblioteka “Moikom Zeqo”?

Z. F. Pullazi: Po!

Z. I. Celibashi: Dakord, ju lutem hapeni mikrofonin për efekt regjistrimi dhe prezantohuni!

Z. F. Pullazi: Quhem Florian Pullazi dhe jam administrator i Njesisë Administrative nr.2, Tiranë.


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë rifillojmë atje ku e kemi lënë dhe me këtë rast... nuk e di përfaqësuesit e organizatës kanë ndonjë gjë për të shtuar veç atyre që keni shtruar dhe saktësimeve që keni bërë në seancën e shkuar?

Z. R. Xhemollari: Jo, do të presim se çfarë do të deklarohet nga përfaqësuesi i njësisë.

Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit! Meqenëse është prezent tashmë, përfaqësuesi i Njesisë Administrative nr. 2, administratori i kësaj njësie, ku ndodhet Biblioteka “Moikom Zeqo”, në lidhje me pretendimet e kërkuesit mbi natyrën e aktivitetit të zhvilluar në Bibliotekën “Moikom Zeqo”, nga kandidati për deputet i Partisë Socialiste atje. Çfarë keni për të na thën, ju lutem?

Z. F. Pullazi: Faleminderit i nderuar Kryetar! Nga shkresa kam marrë njoftimin dhe jam bërë me dije për një takim paraprak që keni pas këtu në Komisionin Qendror të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

Zgjedhjeve, ku janë parashtruar fakte nga pretendimet e organizatës “Qëndresa Qytetare” dhe u paraqita këtu pranë komisionit tuaj. Bibliotekat janë multifunksionale. Unë nuk e di se çfarë pretendimesh ka organizata në fjalë dhe për çfarë konsiston gjithë kjo akuzë? Në kuptimin që Biblioteka “Moikom Zeqo” ndodhet në njësinë nr.2, por duhet të dini që bibliotekat janë multifunksionale, ku mund të ushtrojnë aktivitetin e tyre, organizata, banorë të njësisë nr.2, të rinj e të reja. Janë të hapura për publikun dhe çdo kush mund të bëjë një aplikim. Dua të them që unë nuk kam qenë në takimin e parë dhe nuk kam informacion se ku konsiston e gjithë kërkesa që ka parashtruar organizata. Nga shkresa shoh, por kuptoj që është bërë dhe një gabim për sa i përket vendosjes dhe thirrjes në takimin e parë. Ky është takimi i parë për mua, prandaj doja të dija më tepër se ku konsiston dhe çfarë dhe ku është ankesa drejtuar nga organizata. Se shoh që është shpallur një kandidat për deputet dhe ka bërë takim në atë bibliotekë. Bibliotekat janë të hapura dhe mund ta përdorin të gjithë. Me atë që shoh dhe lexoj në dokumentin që më ka ardhur, për kandidatin për deputet është prezantuar një datë dhe një vend tjetër. Pra, në qoftë se është ky shkaku i ardhjes sot këtu, unë nuk di që të jetë vënë biblioteka e njësisë nr.2 në dispozicion të një aktiviteti politik për të shpallur një kandidat për deputet. Shpallja zyrtare për kandidatin në fjalë që pretendohet është bërë në datën 3 dhe është plotësisht e verifikueshme nga të gjithë. Nuk e di argumentin që sillet.

Z. I. Celibashi: Në mënyrë të përmbledhur pretendimi i organizatës është që në ambientet e Bibliotekës “Moikom Zeqo” është zhvilluar veprimtari elektorale nga ana e kandidatit për deputet të Partisë Socialiste, zotit Alqi Bllako. Pyetja është “është zhvilluar, apo jo aktivitet në të cilin ka marrë pjesë kandidati për deputet i Partisë Socialiste dhe aty është zhvilluar fushatë elektorale? Po, apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

Z. F. Pullazi: Jo!

Z. I. Celibashi: Sipas vlerësimit tuaj... sepse unë këtë kuptova nga ajo çfarë ju thatë “që biblioteka është një ambient multifunksional”. Gjithëkush atje mund të zhvillojë veprimtari të çfarëdolloj natyre. O qëndrojnë të dyja, o qëndron vetëm njëra për ju, por ky është thelbi i asaj ç’ka duam të sqarojmë.

Z. F. Pullazi: Këtu mund të ishte dhe vetë kandidati që mund të sqaronte më shumë, nuk e di. Por në dujeninë time nuk është zhvilluar aktivitet elektoral brenda ambienteve të Bibliotekës “Moikom Zeqo”.


Z. I. Celibashi: Në dijeninë tuaj..., po jashtë dijenisë tuaj mund të sqaroni..., nuk mund të thoni me siguri që është zhvilluar, apo nuk është zhvilluar?

Z. F. Pullazi: Nuk mund ta them me siguri, sepse biblioteka përdoret masivisht nga të rinj e të reja që vijnë dhe nga organizata jofitimprurëse të cilat zhvillojnë aktivitete duke aplikuar në Bashkinë e Tiranës, nëpërmjet një formulari. Brenda funksionit të saj, pra që ka biblioteka.

Z. I. Celibashi: Dakord! Përfaqësuesi i Qëndresës Qytetare para se ta mbyllim!

Z. R. Xhemollari: Në vijim të deklaratave dhe kallëzimit tonë, sigurisht që ne jemi një organizatë e fokusuar që ligji zgjedhor të zbatohet. Që marrëveshja e 5 qershorit dhe ajo që ka prodhuar neni 21 i Kodit Zgjedhor. Pra, mospërdorimi i asteve publike

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

katër muaj para zgjedhjeve të zbatohet që asetet publike, burimet, hapësirat të mos përdoren nga partitë në zgjedhje. Gara të jetë e barabartë dhe që shkelësit e ligjit të ndëshkohen. Kjo është hera e tretë që ne vijmë këtu për këtë çështje. Kemi parë zyrtarë publikë të cilët kanë refuzuar të vijnë këtu. Kemi parë zyrtarë publikë që edhe kanë mashtruar institucionin tuaj duke thënë që “jo është bërë në oborr të shkollës, apo jashtë shkollës, apo është bërë aktivitet kulturor etj. etj.. Ndërkohë që ne kemi depozituar prova të qarta që bëhet fjalë për një aktivitet ku kandidati ju flet mbështetësve të tij, i fton që të votojnë forcën politike. Në kuadër të kësaj, mendoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe autoriteti juaj si Komisioner duhet të ushtrojë autoritetin për të marrë një vendim i cili do të vendosë një standart që këto situata të mos përsëriten më në zgjedhjet e ardhshme, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Faleminderit, përpara se ta mbyllim ju? Shkurt ju lutem!

Z. F. Pullazi: Jo, unë nuk kam asgjë tjetër, sepse po shoh që është më shumë histori politike se sa ka të bëjë me çështjen administrative që jam thirrur këtu. Ju garantoj që nuk ka asnjë lidhje që biblioteka të jetë vendos... Në bibliotekë mund të hyjnë të gjitha forcat politike. Aty nuk ka ndonjë çip që të kontrollojë që është i majtë, apo është i djathtë. Unë garantoj këtë pjesë që biblioteka num është përdorur për këto qëllime elektorale.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit!

Z. R. Xhemollari: Mundet zoti Komisioner?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

Z. I. Celibashi: Po!

Z. R. Xhemollari: Atëhere, kemi të bëjmë me zyrtarë të cilët nuk e njohin ligjin zgjedhor dhe nuk kam çfarë të vazhdoj këtë bisedë, pasi duhet ta dijnë të gjithë zyrtarët dhe të jenë të informuar që, “asetet publike nuk mund të përdoren në fushatë elektorale”.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit, e konsideroj të mbyllur hetimin administrativ në lidhje me këtë çështje. Përpara se të vendos në lidhje me pretendimet e palëve dhe të disponoj në lidhje me kërkesën e kërkuarit, fjala e fundit për kërkuarin dhe përfaqësuesin e njësisë administrative. Shkurtimisht ju kërkoni që të pranohet kërkesa dhe të vendosen sanksione administrative?

Z. R. Xhemollari: Sigurisht, ne i qëndrojmë të gjitha kërkesave tona, të cilat i kemi depozituar edhe në zgjerimin e objektit të hetimit. Kërkesë të cilën e kemi depozituar përfshirë edhe subjektin zgjedhor Partia Socialiste, për sa i përket shkeljes së nenit 172 dhe 91 të Kodit Zgjedhor. Presim një vendim nga ana juaj që të përfshijë një objekt të zgjedheruar në këtë hetim.

Po faleminderit! Përfaqësuesi i Njësisë Administrative nr.2, shkurt ju lutem!

Z. F. Pullazi: Faleminderit zoti Kryetar, duke qenë se dhe vetë kam qenë dy herë i mandatuar nga Komisioni Qendror si anëtar i këshillit bashkiak, ju siguroj që e njoh shumë mirë dhe pjesën e ligjit për përdorimin e aseteve publike. Unë ju përgjigja direkt thirrjes dhe nuk është se neglizhova dhe ato fjalët mund t'i tërheqësh përse i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

përket “mashtimeve e gjërave”, sepse unë erdha këtu për t’iu përgjigjur dhe ballafaquar me të gjitha pretendimet. Ajo që them unë dhe është më kryesoria, bibliotekat janë ambiente multifunksionale. Duke qenë të tilla janë në përdorim të të gjithëve. Se si mund të arësyetoni ju që kjo bibliotekë është përdorur për fushatë elektorale, nuk është e vërtetë. Ju pretendoni se është bërë shpallja për kandidat zyrtar është bërë në vend tjetër dhe në një kohë tjetër. Prandaj për mua duhet të rrëzohet si kërkesë se ne kemi qenë komplet në funksion të punëve tona të përditëshme, ju falenderoj zoti Kryetar!

Z. I. Celibashi: Faleminderit palëve për kontributet e tyre në këtë shqyrtim. Në vlerësim të pretendimeve të të gjitha palëve, por edhe çfarë ata paraqitën si prova dhe argumente në lidhje me këtë shqyrtim, çmoj se jemi përpara shkeljes administrative që lidhen me përdorimin e aseteve publike për qëllime elektorale. Tej faktit që, e vërtetë është që bibliotekat janë ambiente multifunksionale, por do të duhet që qoftë nga ana e Bashkisë Tiranë, apo njësisë administrative të kishte një rregullim në lidhje me këtë çështje. Pra, që qartazi të kuptohej që këto janë asete të cilat në rrethana të caktuara, të imponuara objektivisht, mund të vendoseshin për të falsifikuar veprimtari qoftë elektorale të subjekteve të caktuara. Jashtë, pa këtë dhe në kushtet kur e kemi të provuar, të paktën në vlerësimin tonë, që aty është zhvilluar veprimtari elektorale dhe politike, mendojmë që ata që kanë qenë përgjegjës për të administruar këtë si aset, kanë përgjegjësi. Nuk vlerësoj si të mbështetur kërkesën që subjekti zgjedhor Partia Socialiste të penalizohet për këtë fakt sepse, në fund të fundit, përgjegjësia është për ata të cilët kanë detyrimin për të miradministruar në përputhje me parashikimet e ligjit dhe aktit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, asetet publike. Ndaj,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, të nenit 91, si dhe nenit 171, pika 1, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Vendos:

1. Konstatimin e shkeljes nga ana e Administratorit të Bibliotekës “Moikom Zeqo”.
2. T’i kërkojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, vendosjen e sanksionit administrativ.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 467

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



11.11.2021
Ora 12:40

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për rishqyrtimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në lidhje me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e Bibliotekës “Misto Treska”, me pjesëmarrjen e kandidatit për deputet, zonjës Kledina Skëndo”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**

• **Të tjerë:**


1. Organizata “Qëndresa Qytetare” **R. Xhemollari**

2. Njësia Administrative nr. 2, Tiranë **F. Pullazi (administrator)**

Z.I.Celibashi: Atëherë vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë “me shqyrtimin administrativ bazuar në kërkesën e organizatës “Qëndresa Qytetare”, lidhur me aktivitetin e zhvilluar në bibliotekën “Misto Treska”, kandidatia për deputete, zonja Kledina Skëndo. Janë përfaqësuesit e organizatës present në këtë shqyrtim. Nga njësia administrative nuk ka... Përfaqësuesi i organizatës “Qëndresa Qytetare” në lidhje me këtë?

Z. R. Xhemollari: Përsëri jemi në të njëjtin stad të procesit të kallëzimit. Ju kemi depozituar herën e fundit një provë të re, e cila ishte maska që mbante kandidatia me

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.11.2021*

logon e Partisë Socialiste në takim. Vetë kandidatit kur ishte e pranishme në seancën e kaluar, refuzoi që ai të ishte një takim elektoral. Ne kemi vendosur provat në dispozicion. Aktiviteti është bërë në ambientet e Bibliotekës “Misto Treska”. Ne kemi të njëjtat kërkesa ashtu siç ishte dhe rasti i Bibliotekës “Moikom Zeqo”.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, duke përfunduar shqyrtimin administrativ edhe për këtë çështje, pasi dëgjuam edhe pretendimet tuaja të fundit, vlerësojmë se: në rastin konkret, aktiviteti i zhvilluar në Bibliotekën “Misto Treska”, nuk provohet që të jetë një aktivitet elektoral. Patjetër që ka qenë prezente kandidatit Kledina Skëndo, por nga provat që ju paraqitët, qoftë dhe nga ajo çfarë u pohua këtu në seanca, nuk rezulton që aty aktiviteti të ketë qenë i natyrës elektorale. Në lidhje me provën e fundit paraqitur nga ana juaj është e vështirë të konfirmojmë që ajo lidhet me datën, vendin e zhvillimit të këtij aktiviteti. Për sa kohë, kjo mbetet dyshuese, ne konsiderojmë që nuk mund të merret në vlerësim. Për ta përfunduar, Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, si dhe pika 2, dhe neni 91, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Vendos:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj kandidatit për deputet zonjës Kledina Skëndo, Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe Administratorit të Bibliotekës “Misto Treska”.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Faleminderit, seanca mbyllet!

Vendimi nr. 468

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

